

EMINE ARIFI-BAKALLI

**PËRBALLJA E SHQIPËRISË ME POZITËN
E SHQIPTARËVE NË JUGOSLLAVI
(1935)**

Abstrakt:

Artikulli trajton pozitën e shqiptarëve në Jugosllavi në periudhën midis dy Luftërave Botërore, duke u fokusuar posaçërisht në vitin 1935. Autorja ka mendimin se në kushtet kur nga qarqet politike të Beogradit u konsiderua i pamundur asimilimi i shqiptarëve që jetonin në Jugosllavi, mendimi politik serb i kohës u përqendrua në gjetjen e moduseve për arritjen e spastrimit etnik të popullsisë shqiptare nga trojet e tyre etnike. Programi politik i drejtuesve serbë u fokusua në dëbimin e shqiptarëve drejt Turqisë. Ata shfrytëzuan mjeshtërisht deklaratat politiko-diplomatike të drejtuesve të shtetit turk, për mundësinë e sjelljes në Turqi të të gjithë myslimanëve të Ballkanit. Kjo shkaktoi shqetësim në qarqet politike të shtetit shqiptar. Diplomacia shqiptare bëri demarshet e saj në Ankara, Beograd dhe Romë në mënyrë që shteti jugosllav të hiqte dorë nga përpjekjet që synonin spastrimin etnik të Kosovës dhe viseve të tjera të banuara me shumicë shqiptare në Jugosllavi. Megjithë problemet e rënda ekonomike që kishte Shqipëria, drejtuesit e shtetit shqiptar arritën në përfundimin se, Shqipëria duhej të merrte masa për instalimin në Shqipëri të emigrantëve shqiptarë që synonin të largoheshin drejt Turqisë.

Fjalët kyçe:

Kosova, Shqipëria, Jugosllavia, shpërngulja e shqiptarëve, spastrim etnik, Turqia, emigrantë shqiptarë, Mbreti Zog, Rauf Fico, Xhafer Vila

**Turqia partner real për mundësinë
e dëbimit masiv të shqiptarëve**

Një ndër çështjet që rënduan marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave midis dy Luftërave Botërore ishte dhe pozita e shqiptarëve në Jugosllavi. Siç dihet, shqiptarët përkundër minoriteteve të tjera, përjashto këtu

maqedonasit të cilëve iu mohua plotësisht identiteti kombëtar, nuk gëzuan të drejtat e minoriteteve të garantuara me Traktatin e Sen Zhermenit.* Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene u përkujdes¹ që statusin e minoriteteve ta gëzonin vetëm ato të përfshira brenda këtij shteti, si pasojë e rezultateve gjeopolitike të Luftës së Parë Botërore.² Me fjalë të tjera, shqiptarët mbetën pa status dhe në aktet zyrtare jugosllave të kohës evidencoheshin si popullsi “jo sllave” apo “dhe të tjerë”. Promovimi i kësaj politike mohuese të Beogradit ishte indikacion i qartë se shqiptarët edhe në shtetin e ri të Sllavëve të Jugut sikurse nën Serbinë dhe Malin e Zi (1912-1915) po i priste ballafaqimi me një politikë diskriminuese dhe eliminuese.

Në fakt, me rastin e pushtimit (1912) dhe ripushtimit (1918) të Kosovës dhe viseve të tjera të banuara me shumicë shqiptare, Beogradi u ballafaqua me një realitet të hidhur për të. Numri i shqiptarëve në tokat e pushtuara ishte absolutisht mbizotërues; nataliteti i tyre ishte i madh; identiteti i tyre nacional dhe fetar ishte i konsoliduar; kujtesa e tyre kolektive si ajo e largët, e afërt dhe ajo e përditshme për pushtetin serb ishte predispozitë e fuqishme që thellonte hendekun me pushtuesin e ri. E gjithë kjo, e përjashtonte mundësinë e asimilimit të tyre, prandaj Beogradi nuk investoi shumë mund në këtë rrafsh.*

Diskursi diplomatik serb i paraqiste shqiptarët si problematikë, rebelë dhe element antishtetëror, ndërsa diskursi i brendshëm politik serb ata i përkufizonte si arnautë-mbetje osmane, e cila vendin e kishte në Turqi. Krahas kësaj, mbështetja e pa rezervë e kësaj politike nga ana e qarqeve fetare, shkencore e kulturore serbe e përjashtonte qoftë idenë për akomodimin e shqiptarëve në frymën e standardeve ndërkombëtare për

* Traktati i Sen Zhermenit nënshkruar midis fuqive fituese të luftës dhe Austrisë (10 shtator 1919) parashihte dhe obligimin për mbrojtjen e të drejtave fetare e nacionale të pakicave në shtetin e porsaformuar, Mbretërinë Serbo- Kroate - Slllovene.

¹ *Srbija i Albanci, Pregled politike Srbije prema Albancima*, Knjiga II, Časopis za kritiko znanosti, Univerzitetni konferenci Zveze socialistične mladine Slovenije Maribor in Ljubljana: 1989, f. 47; Jovan M. Jovanović, *Diplomatska Istorija Nove Evrope 1918-1938*, Beograd: I. K. Kosta J. Mihajlović, 1939, f. 241.

² Emine Arifi-Bakalli, “Përpyjekjet e Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” për të drejtat legjitime të shqiptarëve në Mbretërinë SKS”, në *Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”*, 85-vjetori i themelimit: Simpoziumshkencor, 7 nëntor 2003 (përmbledhje kumtesash), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: 2004, f. 32-41.

* Në historiografinë shqiptare teprohet me “asimilimin” si veçori e politikës serbe ndaj shqiptarëve.

minoritete. Aq më keq, këto tri kategori të shoqërisë serbe u bënë krahë të politikës antishqiptare serbe. Si pasojë mendimi politik serb i kohës u përqendrua në gjetjen e moduseve për arritjen e spastrimit etnik të viseve shqiptare³ apo siç shprehej akademiku serb V. Çubrilloviq, spastrimin e “kunjit të dytë arnaut”⁴ në barkun e Serbisë që nënkuptonte Kosovën. Sipas kalkulimeve serbe ky synim mund të arrihej me një marrëveshje për shpërngulje masive e sistematike me Turqinë, të ngjashme me ato që ky shtet kishte lidhur me Greqinë dhe Rumaninë. Duke u nisur nga ky fakt, Beogradi zhvillonte politikë të veçantë dhe shumë anuese ndaj këtij shteti.⁵ Jugosllavia kishte vetëm dy ambasada*, njërën në Rumani si atdhe i Mbretëreshës Maria** dhe tjetrën natyrisht në Turqi.

Në vitin 1935, diplomacia dhe politika serbe sforcuan veprimet drejt një marrëveshjeje me Turqinë. Pozicionimi i Jugosllavisë me rastin e martesës së motrës (Sanije) të Mbretit Zog me një pinjoll osman (princ Abidin) me ç’rast ministri Fuqiplotë jugosllav, Gjonoviç u shqua si organizator i bojkotimit të kësaj dasme⁶, joshi së tepërmi Ankaranë. Kjo ishte e bindur se Shqipëria me këtë hap si dhe me afrimin e sërishëm me Italinë, po punonte kundër interesave të Turqisë.⁷ Kjo bindje u përhap jo

³ Për këtë shih: *Spastrimi Etnik, Dokumente historike mbi një ideologji serbe*, Përmbledhur, përkthyer dhe komentuar nga Mirko Grmek, Marc Gjidara dhe Neven Shimac, Tiranë: Shtëpia Botuese 55, 2002; Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Prishtinë: Koha, 2001, f. 275-300.

⁴ *Arhiv Vojno-Istoriskog Instituta*, Beograd (më tej: AVII), P-17, K-69, f. 2, *Iseljavanje Arnauta*, Predavanje održano u Srpskom Kulturnom Klubu od Dr. Vase Čubrilovića 7 marta 1937 godine. Sipas akademikut serb “kunji i parë shqiptar” (Toplica), u spastrua me “shumë sukses” gjatë viteve 1877-1878.

⁵ *Historija Diplomatiје*, III, Redaktor Vladimir Petrović Potemkin, Zagreb: Matica Hrvatska, 1951, f. 505-507. Beogradi e përkrahu Ankaranë edhe në konferencën ku u trajtua kërkesa e saj për revidimin e statusit të Ngushticave të përcaktuar në Konventat e Lozanës etj.

* Midis dy Luftërave Botërore shtetet përfaqësoheshin kryesisht në nivelin e legatave dhe në krye të tyre qëndronte diplomati me titullin Ministër Fuqiplotë. Vetëm në raste të posaçme kishte ambasada dhe ambasadorë.

** Bashkëshortja e Mbretit Aleksandër.

⁶ Për këtë shih: Emine Arifi-Bakalli, “Konventa jugosllavo-turke për shpërngulje e vitit 1938 në funksion të spastrimit etnik të trojeve shqiptare” në *Gjenocidi dhe aktet gjenocidale të pushtetit serb ndaj shqiptarëve nga Kriza Lindore e këndeј*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Prishtinë: 1995.

⁷ Hasan Bello, *Marrëdhëniet shqiptaro-turke 1912-1939*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: 2015, f. 353-364. Ky studiues mendon se kjo martesë nuk kishte karakter politik por ishte një martesë e thjeshtë.

pak në Turqi sa edhe administratorët e saj po e shprehnin në relacion me emigrantët shqiptarë. Në rastet kur një pjesë e emigrantëve të pakënaqur me trajtimin dhe sistemimin territorial-geografik, kërkonin që t'u lejohej kthimi apo shkuarja në Shqipëri, merrnin përgjigjen se ata donin të shkonin atje për t'u bërë "ushtarë të Italisë".⁸ Përveç kësaj, interesi imediat i Turqisë për marrëdhënie miqësore dhe kontraktuale me Jugosllavinë, rritej krahas afrimit italo-jugosllav dhe sidomos atij jugosllavo-bullgar nën ombrellën italiane. Një kërcënim i drejtpërdrejt për Turqinë. Tehun e këtij rreziku më së miri mund ta pakësonte (për një kohë të gjatë) një marrëveshje për shpërnguljen e shqiptarëve. Prandaj, gjatë vitit 1936, u shpeshtuan kërkesat e Ankarasë për një vizitë të kreut të ri jugosllav M. Stojadinović në Turqi⁹, gjë që dhe ndodhi në tetor 1936 me ç'rast pati manifestime maksimale nderimi e miqësie ndaj tij. Vizitat e këtij niveli përafruan shumë këto dy shtete dhe trasuan rrugën drejt arritjes së Konventës Jugosllavo-Turke për shpërngulje në vitin 1938, nën ombrellën e Paktit Ballkanik.¹⁰ Ç'është e vërteta konventa mbeti në fazën e siglimit dhe pala turke u tregua krejt e mbyllur ndaj insistimit të palës jugosllave për ratifikimin e saj. Sigurisht që në këtë mes ndër të tjera¹¹ ka pasur ndikim dhe dalja jashtë loje i të dy protagonistëve kryesorë me vdekjen e Atatürkut dhe rënien-internimin e Stojadinovićit.

Krahas veprimeve në planin diplomatik, Beogradi intensifikoi zbatimin e Reformës Agrare¹² në emër të së cilës atakohej në radhë të parë shtresa rurale e shoqërisë shqiptare. Kjo shtresë shoqërore

⁸ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme i Republikës së Shqipërisë* (më tej: AMPJ), Viti (më tej: V.) 1936, Dosja (më tej: D.). 165, fleta (më tej: fl.) 123, IV/1936. Raport nga konsullata shqiptare në Stamboll drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme shqiptare.

⁹ Milan Stojadinović, *Ni rat ni pakt*, Otokar Keršovani Rijeka: 1970, f. 378; AMPJ, V. 1936, D. 165, fl. 247. Shkresë e ministrit Fuqiplotë shqiptar, R. Fico drejtuar MPJ shqiptare. Përkundër shkrimeve të shtypit për një konventë jugosllavo-turke për shpërngulje, Stojadinović i mohoi këto lajme, Beograd, 10 nëntor 1936.

¹⁰ Për motivet serbe, ato turke, kontekstin ndërkombëtar, rolin e faktorit shqiptar dhe karakterin e kësaj konvente shih te E. Arifi-Bakalli, "Konventa jugosllavo-turke ...", f. 169.

¹¹ Po aty.

¹² Për këtë shih te Jura Demetrović, *Agrarna reforma u Jugoslaviji - ekspozice u Narodnom Predstavništvu*, Ministarstvo Poljoprivrede Kraljevine Jugoslavije, Beograd: 1933; Milovan Obradović, *Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu (1918-1941)*, Institut za Istoriju Kosova, Priština: 1981; Marenglen Verli, *Reforma agrare kolonizuese në Kosovë 1918-1941*, Tiranë: Iliria, 1992.

shpronësohej deri në atë masë sa që u bëhej e pamundshme jeta në shtëpitë e tyre. Të zhveshur nga mundësia për jetë ata bëheshin më të thyeshëm dhe të gatshëm për shpërngulje. Ajo që Beogradi nuk e arriti para një dekade dukej sikur në kontekstin e ri ndërkombëtar dhe predispozitën e shtetit turk, po bëhej e arritshme. Në fakt, që në vitin 1925 diplomacia shqiptare u ballafaqua me përpjekjet e Beogradit për një marrëveshje me Ankarën¹³, përmes së cilës ky do ta arrinte qëllimin që ishte “pranimi nga ana e Turakisë i emigrantëve nga Kosova dhe Maqedonia”¹⁴ - siç konstatonte përfaqësuesi shqiptar në Beograd, Gj. Pekmezi. Në qarqet politiko-diplomatike turke flitej hapur lidhur me mundësinë që në Turqi të sillleshin përse jo të gjithë myslimanët e Ballkanit. Ishte kjo koha kur Ataturku promovonte politikat e distancimit nga trashëgimia osmane në favor të ruajtjes dhe fuqizimit të Republikës Turke.¹⁵ Tema për mundësinë e një marrëveshjeje Beograd-Ankara për shpërnguljen e një numri të madh banorësh myslimanë, u aktualizua sidomos në kohën e negociimit dhe të arritjes së marrëveshjes turko-anglo-irakiane për Mosulin. Sipas qarqeve qeveritare turke, çmimi i tërheqjes turke nga kjo krahinë do të ishte zhvendosja e mbi një milion kurdësh nga Turqia për në “Kurdistan”.¹⁶

Ministri Tefik Ruzhdi fliste për synimin që nga Serbia të pranoheshin 3-400.000¹⁷ myslimanë të cilët do të duhej të sistemoheshin në tokat e kurdëve të shpërngulur.¹⁸ Në Parlamentin Turk, Kryeministri I. Inoni

¹³ *Diplomatski Arhiv Saveznog Sekretariata Inostranih Poslova*, Beograd (më tej: DASSIP), LP, 1925, F. II/a, fl. 360. Nënshkrimi i Marrëveshjes për Paqe e Miqësi Turqi-Mbretëria Serbo-Kroate-Slllovene, 28 tetor 1925.

¹⁴ *AMPJ*, V. 1925, D. 112, fl. 143-144. Kryesi i detyrës në Beograd, Gj. Pekmezi në raportin për Tiranën, konstatonte “... një ndër pikat ma të para të programit të Jugosllavisë për me mujt me hy në marrëdhënie me Turkinë , asht pranimi nga ana e Turakisë i emigrantëve nga Kosova dhe Maqedonia”, Beograd, 8 prill 1925.

¹⁵ Për këtë shih Patrick Kinross, *Ataturku, Rilindja e një kombi*, Tiranë: Eegen, 2003, dhe Heaton C. Armstrong, *Ujku i Murrme, Jeta dhe vepra e Mustafa Qemal Ataturkut*, Tiranë: Konica Color, 2008.

¹⁶ *AMPJ*, V. 1926, D. 101, fl. 6-7. Raport i ministrit Fuqiplotë në Turqi, Fico drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme, I. Vrioni, Ankara, 30 mars 1926.

¹⁷ *Po aty*. Shtypi serb trumbetonte se në Turqi mund të shpërnguleshin deri “në 450.000 banorë nga Serbia Jugore...”. “Iseljavanje Turaka iz Juzhne Srbije”, *Novosti*, Beograd, 8 mars 1925.

¹⁸ *Po aty*, fl. 28. Raport i ministrit Fuqiplotë shqiptar në Turqi drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme I. Vrioni, Ankara, 5 qershor 1926; *po aty*, fl. 22. Shkresë e ministrit të Punëve të Jashtme të Shqipërisë drejtuar Ministrisë së Brendshme shqiptare, Tiranë,

kishte deklaruar se ishte program kombëtar turk që tokat e boshatisura të Turqisë t'i popullonin me emigrantë të cilët “do të turqizohen”, gjë që nënkuptonte edhe myslimanët jo turq. Madje, një prej deputetëve turq kishte deklaruar se Ankaraja kishte pretendime që në Turqi të silleshin dhe myslimanët e Shqipërisë.¹⁹ Në këtë frymë shkruante dhe shtypi turk.²⁰ I zhgënjyer nga ky qëndrim i qarqeve qeveritare turke, ministri Fuqiplotë shqiptar i kohës në Turqi R. Fico, konstatonte se premtimet dhe deklaratat qetësuese nga kjo anë në kuptimin që shqiptarët do të përjashtoheshin nga kombinimet për shpërngulje në Turqi, s'ishin veçse “hi në sy”.²¹ Përkundër kësaj, diplomacia shqiptare nuk reshti me demarshet pranë Ankarasë në mënyrë që kjo të hiqte dorë nga kombinimet me Beogradin të cilat do të rezultonin me spastrimin etnik të Kosovës dhe viseve të tjera të banuara me shumicë shqiptare.²²

Në vitin 1935, Turqia sërish po shfaqte më shumë interesim për pranimin dhe sistemimin e emigrantëve shqiptarë, duke u shfajësuar para diplomacisë shqiptare se këta vinin nga qytetet (Prizren, Prishtinë, Gjilan) dhe e flisnin turqishten aq sa të konsideroheshin turq. Jo vetëm kaq. Ministri turk i Punëve të Brendshme në një fjalim në Parlamentin Turk kishte deklaruar se nga Jugosllavia në Turqi do të silleshin 800.000 emigrantë. Në Turqi tashmë po zhvillohej fushata për të krijuar atmosferën e emigrimit dhe pranimit të “gjithë myslimanëve tonë nga Jugosllavia”²³, siç shkruante gazeta “Haber” (15 korrik 1935) në një

maj 1926; *po aty*, fl. 9. Raport i ministrit Fuqiplotë shqiptar në Ankara R. Fico, drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme I. Vrioni, Ankara, 24 prill 1926; *po aty*, fl. 6-7. Raport i ministrit Fuqiplotë në Turqi Fico drejtuar ministrit të Jashtëm I. Vrioni, Ankara, 30 mars 1926. Sipas ministrit Fuqiplotë austriak në Turqi A. Kral, këtë gjë e kishte pohuar ministri Tefik Ruzhdi në bisedë me ministrin Fuqiplotë sovjetik dhe me ambasadorin e Persisë në Ankara.

¹⁹ *Po aty*, fl. 28. Raport i ministrit Fuqiplotë shqiptar në Turqi drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Ankara, 5 qershor 1926.

²⁰ H. Bello, *Marrëdhëniet shqiptaro-turke ...*, f. 279.

²¹ *AMPJ*, V. 1926, D. 101, fl. 28. Raport i ministrit Fuqiplotë shqiptar në Turqi drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Ankara, 5 qershor 1926.

²² *Po aty*, V. 1935, D. 185, fl. 162. Shkresë e Ministrisë së Punëve të Jashtme shqiptare drejtuar ministrit Fuqiplotë shqiptar në Beograd, Tiranë, 22 korrik 1935. Demarshet pranë qeverisë në Ankara kishte pasur pa ndërprerje; *po aty*, V. 1926, D. 101, fl. 18. Tiranë, 12 korrik 1926. Udhëzim i ministrit të Jashtëm shqiptar për legatën shqiptare në Ankara.

²³ *AMPJ*, V. 1935, D. 185/1, fl. 4. Raport i konsullit shqiptar në Stamboll drejtuar ministrit të Jashtëm, Xh. Vila, Stamboll, më 18 korrik 1935.

artikull me titull “Shqiptarët dhe boshnjakët janë nga fisi turk”. Konsulli shqiptar në Stamboll nga “një mik” i tij në Ankara, u informua se prapa këtij artikulli qëndronte vetë Ataturku. Këtij iu paskan ankuar disa emigrantë kosovarë të mbetur rrugëve e pa përkujdesje nga pushteti, me ç’rast Ataturku kishte kërkuar që t’u lehtësohej instalimi në Thraki²⁴, krahas të shpërngulurve nga Rumania.²⁵ Prandaj dhe kërkesat e Ficos, në këtë kohë ministër Fuqplotë në Beograd, drejtuar homologut të tij turk Hajdar Beut, që ai të angazhohej pranë qeverisë në Ankara në mënyrë që të mos lehtësohej shpërngulja e kosovarëve, të shumtën e herës, mbetën pa jehonë.²⁶

Tirana kishte informacione për trajtim jo të mirë të shqiptarëve në Turqi dhe për një frymë antishqiptare atje.²⁷ Emigrantët shqiptarë me qëllim asimilimi të shpejtë të tyre, po shpërndaheshin nëpër fshatrat turke vetëm nga një familje dhe po hiqej dorë nga praktika që ata të vendoseshin së bashku në një vendbanim. Konsulli shqiptar në Stamboll kishte krijuar bindjen se premtimet e Ministrisë së Punëve të Jashtme turke lidhur me shpërnguljen e kosovarëve nuk ishin aspak të sinqerta sepse shërbimi i tyre në Jugosllavi ndër shqiptarë po “agjitonte” shpërnguljen në Turqi. Ky konstatonte se blloku qeveritar turk nuk kishte simpati për Shqipërinë nga “shkaku i ndodhjes të disa njerzvet të nalt prej origjine shqiptare si Mustafa Qemali Pasha , Qazim Pasha dhe disa të tjerëve që simpatizojn Shqipërinë”.²⁸ Madje kishte ra në sy se nëpunësit me prejardhje shqiptare të mbetur në Turqi, evitonin komunikimin në gjuhën shqipe sepse në këtë mënyrë mund të humbnin vendet e punës.²⁹

²⁴ *Po aty.*

²⁵ *Po aty.*

²⁶ *Po aty*, V. 1935, D. 185, fl. 162. Shkresë urgjente e ministrit të Jashtëm Xh. Vila, drejtuar R. Ficos mbi kërkesën e pesëdhjetë kryefamiljarëve prishtinas për shpërngulje në Turqi, në konsullatën turke në Shkup, Tiranë, 22 korrik 1935.

²⁷ *AMPJ*, V. 1936, D. 165, fl. 121. Raport nga konsullata shqiptare në Stamboll: Mendohej se 100.000 shqiptarë të ndodhur në Turqi të “viseve të ndryshme të Shqipërisë së lirë dhe të robnueme, mund të nisen në Shqipëri”.

²⁸ *Po aty*, V. 1935, D. 185, fl 4-5. Raport i konsullit shqiptar në Stamboll drejtuar ministrit të jashtëm Xh. Vila, Stamboll, 15 kallnuer 1935.

²⁹ *Po aty.*

Shteti shqiptar përballë dëbimit të shqiptarëve

Së pari, ka nevojë të shpjegohet përse në dokumentacionin arkivor shqiptar të kohës, kur bëhet fjalë për çështjet që kishin të bënin me shpërnguljen e shqiptarëve, kryesisht bëhet fjalë për Kosovën dhe kosovarët? Në fakt, nga korrespondenca diplomatike shqiptare del se në Tiranë kishte një pajtim që të veprohej për parandalimin e shpërnguljes së shqiptarëve, pikërisht nga Kosova në kuptimin e ngushtë të fjalës. Në udhëzimet që jepte ministri shqiptar i Punëve të Jashtme Xh. Vila për përfaqësitë diplomatike shqiptare në Jugosllavi, precizohej se duhej bërë çmos që të parandalohej shpërngulja “e kosovarëve” dhe madje duke i refuzuar ata nga ana e autoriteteve shqiptare, ndërsa “...Sa për pjesën e shqiptarëve që rrojnë në vise të ndryshme të Maqedonisë dhe jo të Kosovës, ata duhen pranuar lirisht (në Shqipëri)”³⁰ - sugjeronte ai.

Strukturat qeverisëse të shtetit shqiptar kanë qenë mirë të informuara për masat represive të zbatuara kundër shqiptarëve nga strukturat shtetërore jugosllave po dhe nga grupe e individë të veçantë. Burimet e këtyre informacioneve ishin të shumanshme, duke nisur me personalitete të dalluar shqiptarë me mundësi informimi e që ishin në kontakt me Tiranën zyrtare, siç ishte p.sh., politikani Ferhat Draga dhe një rrjet i tërë informatorësh të organizuar dhe paguar. Raporte lidhur me përjetimet tragjike të shqiptarëve në Jugosllavi, bëheshin dhe nga individë e grupe të ikur në Shqipëri, në Turqi e gjetiu. Edhe konsullatat shqiptare në Selanik dhe në Stamboll nga kontaktet me të shpërngulurit po dhe kategori të tjera nga Kosova, si tregtarë e afaristë, siguronin informacione me vlerë. Natyrisht fjalën kryesore në këtë mes e kishte legata shqiptare në Beograd dhe dy konsullatat shqiptare, ajo në Manastir³¹ e sidomos ajo në Shkup³², të cilat preokupim parësor kishin pozitën e shqiptarëve në Jugosllavi. Pikërisht kjo ishte arsyeja e ankesave të tyre të shumta për kushte shumë

³⁰ AMPJ, V. 1935, D. 185, fl. 102, Tiranë, 28 qershor 1935; *po aty*, fl. 166. Udhëzime të Xh. Vilës për kryekonsullin shqiptar në Shkup, Tiranë, 25 korrik 1935.

³¹ *Po aty*, V. 1936, D. 165, fl. 104-105. Raport i konsullit shqiptar drejtuar ministrit të jashtëm Dr. F. Asllanit për zhvillimet në komunitetin shqiptar të atij rajoni, Manastir, 8 maj 1936.

³² *Po aty*, fl. 62-65. Raport i kryekonsullit shqiptar në Shkup. Evidencohet dhe një organizatë e fshehtë e cila zbatonte në terren objektivat shqiptare, Shkup III/1936 (protokolluar më 13 mars 1936).

të vështirësuar veprimi si pasojë eurvejimit dhe e ndërhyrjeve të autoriteteve lokale jugosllave.³³

Në fillim të vitit 1935, në qarqet diplomatike dhe politike shqiptare u krijua bindja se premtimet e dhëna vitet e fundit dhe të aty-këtushme nga ana e përgjegjësve të Beogradit për përmirësimin e pozitës të shqiptarëve madje dhe për mundësinë e hapjes së shkollave bazike në gjuhën shqipe³⁴, nuk kishin qenë aspak të sinqerta. Këto premtime aq më keq, nuk u bënë në funksion të afrimit dhe bashkëpunimit miqësor midis dy vendeve, por sa për ta qetësuar Tiranën. (Beogradi llogariste pozicionin specifik të Shqipërisë në relacion me Jugosllavinë). Asaj nuk i konvenonte acarimi i marrëdhënieve me fqinjën ballkanik, gjë që do të ndodhte në rast të alarmimit të kësaj çështjeje në nivel ndërkombëtar, çfarë mund të paraqiste një ankesë zyrtare pranë Lidhjes së Kombeve.³⁵

Sipas informacioneve të përfaqësive diplomatike shqiptare në fillim të vitit 1935, emigrimi “i kosovarëve për Turqi po merrte dita-ditës një zgjerim më të madh”.³⁶ Ata grumbulloheshin në Selanik³⁷ dhe nga aty vazhdonin rrugën për në Turqi.³⁸ Prezenca e “kosovarëve” në Selanik

³³ Për këtë shih te E. Arifi-Bakalli, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1929-1939*, Biblioteka Kombëtare-Kosovë, Tezë doktorate 1984; *AMPJ*, V. 1931, D. 81, fl. 75. Raport i konsullit shqiptar në Shkup drejtuar MPJ të Shqipërisë, Shkup, 10 prill 1931. Duhet të evidencohet se në vitin 1936, konsulli shqiptar në Manastir informon për qëndrim korrekt të autoriteteve jugosllave ndaj kësaj konsullate (*Po aty*, V. 1936, D. 129, fl. 55-60. Shkresë e konsullit shqiptar drejtuar ministrit Fuqiplotë shqiptar në Beograd, R. Ficos).

³⁴ *Po aty*; *AMPJ*, V. 1932, D. 118, fl. 24. Raport i R. Ficos për bisedën me Kryeministrin jugosllav B. Jeftiq, Beograd, 23 nëntor 1932.

³⁵ *Arhiv Jugosllavije* (më tej: *AJ*), Centralni Pres Biro (CPB), (38-20-61), 1929, nr. 136. Raport i atasheut jugosllav për shtyp për CPB, Tiranë, 15 shtator 1929; *AMPJ*, V. 1930, D. 194, fl. 2553/II. Raport i M. Frashërit për Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Gjenevë, 13 shtator 1930.

³⁶ *AMPJ*, V. 1935, D. 185, fl. 20-21. Shkresë e konsullit shqiptar drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme Xh. Vila, Selanik, 25 shkurt 1935; Bie fjala në shkurt 1935 pati 100 emigrantë, ndërsa në mars 210 emigrantë (*po aty*, fl. 25. Raport i konsullit shqiptar në Selanik për Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Selanik, 4 mars 1935).

³⁷ Sipas konsullit shqiptar në Selanik, aty arrinin “pothuaj 100 emigrant në javë”. (*Po aty*, fl. 20. Raport i konsullit shqiptar drejtuar ministrit Xh. Vila, Selanik, 25 fruer 1935).

³⁸ Përjetimet e tyre gjatë kësaj rruge ishin me përmasa golgotiane. Vdekje të njerëzve të dobët (fëmijë, pleq), ngordhje kafshësh që kishin marrë me vete, trajtim jo të mirë nga autoritetet turke, sistemim në toka të humbura me klimë krejt tjetër...

ishite aq e dukshme sa që për ta nisi të shkruajë dhe shtypi grek.³⁹ Sipas konsullit shqiptar në Selanik, rol në këtë shpërngulje kishin edhe agjitorët shqiptarë të cilët merrnin dhe rolin e drejtuesve të grupeve të shpërngulura. Konsullata shqiptare mori detyrën që këta emigrantë të binden që të ndryshojnë drejtim dhe të merrnin rrugën për në Shqipëri përkundër vështirësive financiare në këto raste.⁴⁰

Ndër diplomatët që u mor më së shumti me çështjen e pozitës së shqiptarëve në Jugosllavi ishte Rauf Fico. Ky nuk linte rast pa e shtruar çështjen e pozitës së shqiptarëve jo vetëm në bisedat zyrtare në kuadër të institucioneve përkatëse po edhe në takime rasti, jo vetëm me zyrtarët jugosllavë po dhe me homologët evropianë e personalitete të tjera. Çështjen e pozitës së shqiptarëve, Ficoja e shtroi në takimin e rastit me dy anëtarët e Regjencës jugosllave, Stanković dhe Perović. Ai shprehu shqetësimin lidhur me faktin se në Jugosllavi “minoriteti shqiptar i përmbamë prej 800.000 myslimanëve dhe 40.000 katolikëve nuk ka asnjë shkollë...”⁴¹ Regjentët reagueshan sa i përket numrit të shqiptarëve dhe pohuan një shifër prej 450.000 syresh, por u treguan të matur sa i përket shqetësimit të Ficos për çështjen e shtruar, madje njëri prej tyre, Stanković sipas Ficos “mu shpreh me simpati për këtë çështje”.⁴² Por, ndryshe nga këta, autoritetet e Ministrisë së Punëve të Jashtme jugosllave si zëvendësministri i Jashtëm, Puriq e të tjerë, u treguan shumë të drejtpërdrejtë. Ata, ia bënë me dije ministrit Fuqiplotë shqiptar se sipas ligjeve në fuqi për shtetësinë e Jugosllavisë (Neni 55) të gjithë josllovët kurdoherë mund të pretendonin nënshtetësi tjetër dhe asnjëherë nuk privoheshin nga pasaporta “madje nëse ata nuk udhëtojnë edhe deri në fund të vitit”.⁴³ Ata kundërshtuan që çështja të shtrohej zyrtarisht, pasi emigrimi konsiderohej çështje e brendshme e shtetit. Por, Ficoja këmbëngulës, iu dokumentoi bashkëbiseduesëve përmes fotografive se një pjesë e emigrantëve shqiptarë të nisur për në Turqi ishte vendosur në

³⁹AMPJ, V.1935, D. 185, fl. 20. Raport i konsullit shqiptar drejtuar ministrit Xh. Vila, Selanik, 25 fruer 1935.

⁴⁰Po aty.

⁴¹Po aty, fl. 28. Raport i R. Ficos për takimin me regjentët jugosllavë drejtuar ministrit të Jashtëm shqiptar, Beograd, 7 fruer 1935.

⁴²Po aty.

⁴³Po aty, fl. 33-34. Raport i R. Ficos për ministrin e Punëve të Jashtme shqiptare, Beograd, 5 prill 1935. Afatet e shkurtra të vlefshmërisë së pasaportës bëheshin me qëllim presioni për shpërngulje brenda afatit të caktuar.

Shqipëri dhe se kombësia e tyre ishte e qartë prandaj Shqipëria ishte e obliguar për kujdesin ndaj tyre.⁴⁴ Më 20 prill 1935, Fico në takimin që pati me Kryeministrin dhe ministrin e Jashtëm Jeftiq, shtroi dhe çështjen “delikate të emigrimit të kosovarëve” i cili po bënte përshtypje shumë “të hidhur në Shqipëri”. Ai përmendi emigrimin nga qytetet si Gjilani, Prishtina, Prizreni, banorët e të cilëve “zotnia e juaj e dini ma mirë se unë”, nuk janë turq siç pretendohet. Jevtiqi premtoi se do të fliste me kompetentët dhe të “urdhëronte ndalimin e emigrimit të shqiptarëve”.⁴⁵

Pas gjithë përpjekjeve të shtrira në vite njëherë si ministër Fuqiplotë në Ankara⁴⁶, si deputet në Parlamentin Shqiptar e sidomos që nga viti 1929 si ministër shumëvjeçar Fuqiplotë shqiptar në Beograd, Ficoja konstatonte se “demarshet e kufizuara”⁴⁷ të bëra pranë autoriteteve përkatëse jugosllave nuk do të kishin asnjë ndikim në të mirë të çështjes, e që ishte parandalimi i shpërnguljes së shqiptarëve.⁴⁸ Po kështu, ai shtroi çështjen delikate me të cilën po ballafaqohet shërbimi diplomatik shqiptar në Jugosllavi, i cili për të parandaluar shpërnguljen e “shqiptarëve” refuzonte pajisjen e tyre me dokumentacionin përkatës. Të lënë në mes rrugësh ata ia mësynin Turqisë. R. Fico erdhi në përfundim se emigrimi i shqiptarëve në Turqi ishte në interesin e të dy palëve, pra jo vetëm të Jugosllavisë po dhe të Turqisë, prandaj ky proces nuk mund të ndalej. Ky realitet i hidhur e shtyu atë që të kërkonte nga Tirana “të marri masat për instalimin në Shqipëri të emigrantëve që do të insistojnë në ikje”.⁴⁹

⁴⁴ *Po aty*. Ficoja deklaroi se shqiptarët e shpërngulur “si të dalin nga Jugosllavia dëshirojnë me ardhë në Shqipëri” dhe pra ishte fare e natyrshme që Shqipëria të interesohet “për me ndaluar mjerimin e bashkëracasvet të saj”.

⁴⁵ *AMPJ*, V. 1935, D. 143, fl. 57. Raport i Ficos për Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Beograd, 20 prill 1935.

⁴⁶ Gjatë shërbimit në Turqi ai kishte bërë demarshet të vazhdueshme për çështjen. (*Po aty*, V. 1926, D. 101, fl. 17. Kërkesë e ministrit të Punëve të Jashtme të Shqipërisë drejtuar ministrit Fuqiplotë shqiptar në Ankara, Tiranë, 10 korrik 1926).

⁴⁷ Kjo sintagmë është shumë domethënëse dhe e saktë, sepse mbulon karakterin e demarshëve shqiptare drejtuar kompetentëve jugosllavë. Në vitin 1926 ministri i Jashtëm I. Vrioni porosiste ministrin Fuqiplotë shqiptar në Beograd që të insistohet tek autoritetet jugosllave që të hiqej dorë nga shpërngulja e shqiptarëve, por “miqësisht dhe në mënyrë verbale”. (*AMPJ*, V. 1926, D. 101, fl. 14. Udhëzim nga ministri i Jashtëm I. Vrioni drejtuar legatës shqiptare në Beograd, Tiranë, 24 maj 1926).

⁴⁸ *Po aty*.

⁴⁹ *Po aty*, V. 1935, D. 185, fl. 33-34. Raport i R. Ficos për ministrin e Punëve të Jashtme shqiptar, Beograd, 5 prill 1935; Një pozicion shumë i ngjashëm me atë të M. Frashërit

Pas analizave dhe ankesave të Ficos, dukej sikur Tirana po pajtohej me faktin se shpërngulja e shqiptarëve nga Kosova ishte e paevitueshme. Më tej pasoi udhëzimi i ministrit shqiptar të Punëve të Jashtme për përfaqësitë përkatëse diplomatike ku konstatohej se qeveria shqiptare kishte bërë ç'është e mundshme që popullsia kosovare të qëndrojë në “vatrat e tyre shekullore” dhe për këtë çështje kishte bërë demarshe të vazhdueshme pranë qeverisë jugosllave. Përkundër kësaj, autoritetet jugosllave kishin ndërmarrë masa të vazhdueshme (në emër të Reformës Agrare) që ta bëjnë të pamundshme jetën e shqiptarëve në Kosovë. Kosovarët duke mos pasur përkrahjen e qeverisë shqiptare për emigrim në Shqipëri iu drejtuan dhe po i drejtoheshin Turqisë, e cila ishte e interesuar për këtë “element të fortë e të shëndetshëm siç janë kosovarët”. Shqipëria e kishte të pamundshme që të qëndronte indiferente ndaj kësaj çështjeje sepse kjo kishte të bënte me “600 ose 700.000 shqiptarë, po thua një Shqipëri e dytë”. Rreziku që të gjithë këta të sistemoheshin në Azi ishte real dhe Kosova do të përfundonte në një “shprehje gjeografike pa ndonjë shqiptar”. Ministri i Jashtëm, Vila përfundonte se, skenari i shpërnguljes së kosovarëve dhe tretja e tyre në fushat e Azisë do të duhej të kishte alternativë e kjo ishte pranimi i tyre në Shqipëri “ku qeveria mbretërore do tu bëjë çdo lehtësi për t'i vendosur në mënyrë racionale”.⁵⁰

Konsullatat shqiptare duke nisur me atë të Shkupit, të Selanikut po dhe të Stambollit vepruan që kjo çështje të gjente zgjidhje në pajtim me interesat shqiptarë. E para, që përmes propagandës të ndikojë që shqiptarët mos të shpërnguleshin nga vendbanimet e tyre, e dyta, që të shpërngulurit për në Turqi ta kthejnë rrugën drejt Shqipërisë, ndërsa e treta, që të arriturit në Turqi të mos zinin vend aty po të zhvendoseshin në Shqipëri. Ky aktivitet nuk mbeti pa efekte. P.sh. në gusht të vitit 1935, për mundësinë e vendosjes në Shqipëri u interesua një përfaqësues i treqind familjeve të shpërngulura në Turqi dymbëdhjetë vite më parë nga fshati Prapashticë. Ata nuk kishin gjetur mirëkuptim nga pushteti turk.⁵¹ Por, nga ana tjetër, ndodhte që familje të shpërngulura nga Turqia në

dhjetë vite më parë (*po aty*, V. 1925, D. 117, fl. 30. Raport i Mit'hat Frashërit për ministrin e Jashtëm shqiptar, Athinë, 9 mars 1925, nr. 301).

⁵⁰ *Po aty*, V. 1935, D. 185, fl. 57-58. Shkresë e ministrit të Punëve të Jashtme shqiptar drejtuar shërbimit diplomatik shqiptar (Beograd, Shkup, Stamboll), Tiranë, 27 prill 1935.

⁵¹ *Po aty*, fl.98. Shkresë informative drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme, Xh. Vila, nga konsulli shqiptar në Stamboll, Stamboll, 26 gusht 1935.

Shqipëri të pakënaqura me trajtimin dhe sistemimin atje, të ktheheshin sërish në Turqi.⁵² Që mos të përsëritej kjo dukuri, konsulli shqiptar në Stamboll propozonte praktikën e Turqisë, që të pakënaqurve t'u merreshin pasaportat dhe të pajiseshin me ndonjë kartë identiteti të përkohshme.⁵³ Kurse, në rastet kur të shpërngulurit në Turqi kërkonin që të ktheheshin në Kosovë, merreshin përfaqësitë jugosllave në Turqi. Ato e kishin për detyrë që ky kthim t'u bëhej i pamundshëm.⁵⁴

Ndryshimi në kreun e Jugosllavisë (korrik 1935), ishte një rast që të shtrohej sërish çështja e pozitës së shqiptarëve. Nga ministri Fuqiplotë R. Fico, Tirana kërkoi që, atje, përveç me Kryeministrin e ri Stojadinoviç, çështjen ta trajtonte edhe me dy ministra, sllovenin Koroshec (ministër i Brendshëm) dhe boshnjakun Spaho⁵⁵ (ministër për Komunikacion). Ky adresim nuk dukej se kishte të bënte me dikasteret që ata drejtonin, sa për faktin që njëri ishte slloven dhe kishte përvojën austro-hungareze të trajtimit të minoriteteve dhe tjetri, Spaho ishte mysliman dhe do të duhej të kishte ndjesi dhe interesim për fatin e myslimanëve. Po kështu, Ficoja çështjen duhej ta shtronte dhe me ministrin Fuqiplotë britanik në Beograd. Ai udhëzohej që në “mënyrën më energjike” Kryeministrit jugosllav t'ia bënte me dije se presioni i autoriteteve jugosllave për të detyruar kosovarët për emigrim në Turqi “nuk asht një vepër miqësore”⁵⁶ dhe prej tij pritej që të ndaloheshin këto veprime. Beogradi duhej ta dinte se vazhdimi i kësaj politike do të cenonte seriozisht “relacionet miqësore midis dy shteteve”.⁵⁷ Demarshe për çështjen bëri dhe vetë ministri shqiptar i Punëve të Jashtme në takimet me ministrin Fuqiplotë jugosllav në Tiranë.⁵⁸

Ficoja vazhdoi me traditën që edhe në evenimente rasti ta shtronte çështjen e pozitës së shqiptarëve dhe detyrimin e tyre për shpërngulje.

⁵² *Po aty*, fl. 89. Shkresë informative drejtuar ministrit të Jashtëm shqiptar, Xh. Vila, nga konsulli shqiptar në Stamboll, Stamboll, 12 qershor 1935.

⁵³ *Po aty*, fl. 98. Raport i konsullit shqiptar në Stamboll drejtuar ministrit të Jashtëm, Xh. Vila, Stamboll, 26 gusht 1935.

⁵⁴ *DASSIP*, TP, F.9, nr. 373. Shkresë me udhëzime e MPJ të Jugosllavisë drejtuar ambasadës së saj në Turqi, Beograd, 23 korrik 1926.

⁵⁵ *AMPJ*, V. 1936, D. 165, fl. 57. Këtij ministri i drejtoheshin ankesa dhe nga shqiptarët e përndjekur dhe të shpronësuar.

⁵⁶ *Po aty*, V. 1935, D. 185/1, fl. 35. Shkresë e ministrit të Jashtëm Xh. Vila drejtuar ministrit Fuqiplotë në Beograd R. Fico, Tiranë, 8 gusht 1935.

⁵⁷ *Po aty*.

⁵⁸ *Po aty*.

Këtë e bëri dhe në darkën e shtruar për korin diplomatik (2 gusht 1935) nga Stojadinoviq. Nga Kryeministri jugosllav, Ficoja u informua se për trajtimin e çështjes tashmë ishte formuar një komision i jashtëzakonshëm. Më 3 gusht 1935, çështja u shtrua dhe me Martinac (sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme jugosllave) me ç' rast me fakte konkrete u përshkruan masat për detyrimin e kosovarëve për shpërngulje në Turqi, tashmë edhe “përmes Bullgarisë”.⁵⁹ Edhe njëherë u potencua se ndaj këtyre masave kundër shqiptarëve, Shqipëria nuk mund të qëndronte indiferente “dhe marrëdhëniet e singerta që kishin filluar të krijohen me aq mundime dhe mbas 20 vjetëve të kalueme me kaq grindje, mund të turbulloheshin përsëri”.⁶⁰ Kësaj radhe Martinac u shpreh i matur në kuptimin që deklaroi se masat në fjalë atij nuk i pëlqenin dhe premtoi se në takimin e Komisionit të Posaçëm do ta shtronte këtë çështje.⁶¹

Në ndërkohë, Ficos i erdhi një informatë inkurajuese sipas së cilës qeveria jugosllave tashmë kishte urdhëruar ndalimin e konfiskimeve të tokave të shqiptarëve dhe ishte zotuar se do të procedonte me “abrogimin e ligjeve të Reformës Agrare”.⁶² Kjo ishte e mjaftueshme që ky të shpresonte për një kthesë pozitive në pozitën e shqiptarëve dhe shpejtoi që të nxirrte përfundimin se nëse do të ndodhte kjo, kosovarët “mbas këndeje do të kenë të siguruar jetesën e tyre dhe do të marrin pjesë në rregullimin e jetës shoqërore e politike, në përputhje me zotësinë e bashkimit të tyre”.⁶³ Ky përkufizim i Ficos në fakt definon objektivin kryesor politik të shtetit shqiptar në relacion me shqiptarët në Jugosllavi në kontekstin e dhënë historik. Por, së shpejti Ficoja do të ballafaqohej me faktin se Komisioni Ndërministror i qeverisë jugosllave⁶⁴ të cilin e përmendën dy autoritetet jugosllave, detyrë primare kishte jo të hulumtojë mënyrat e akomodimit të shqiptarëve po mënyrat e eliminimit dhe spastrimit etnik të tokave të tyre. Prandaj, diplomati shqiptar edhe më tej u detyrua që të vazhdojë me ankesat e tij për pozitën dhe të drejtat

⁵⁹ *Po aty*, fl. 64. Raport i ministrit Fuqiplotë R. Fico drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme Xh. Vila, Beograd, 3 gusht 1935.

⁶⁰ *Po aty*.

⁶¹ *Po aty*.

⁶² *Po aty*.

⁶³ *Po aty*.

⁶⁴ Për këtë shih Hakif Bajrami, “Shpërngulja e shqiptarëve në Turqi gjatë viteve 1912-1941”, në *Gjenocidi dhe aktet gjenocidale të pushtetit serb ndaj shqiptarëve nga Kriza Lindore e këndeje*, ASHAK, Prishtinë: 1995.

e shqiptarëve. Në një takim rasti, çështjen e pozitës së shqiptarëve ai e shtroi me regjentin Ivo Peroviq, të cilit i kujtoi prejardhjen e tij nga një fshat arbëresh pranë Zarës* me ç'rast biseda u zhvillua në shqip. Sipas Peroviqit, ky e paska shtruar çështjen e trajtimit dhe të hapjes së shkollave minoritare për shqiptarët me vetë Stojadinoviqin.⁶⁵ Kurse, në takimin e lamtumirës me dy regjentët jugosllavë (Stankoviq, Peroviq), Fico deklaroi se miqësia midis dy vendeve varej kryekëput nga mënyra e trajtimit të shqiptarëve dhe nga hapja e shkollave minoritare.⁶⁶

Çështjen e shpërnguljes së shqiptarëve e shtroi dhe F. Asllani, ministër Fuqplotë shqiptar në Londër. Në takimin që ky pati (24 tetor 1935) me homologun jugosllav atje Gruiq, i shfaqti brengosjen e tij, që ende nuk ishte “rregulluar çështja për mënyrën e veprimit të pushtetit policor jugosllav”⁶⁷, të cilët po bënin presion tek popullsia shqiptare “që të shpërngulej në Turqi, ndërsa iu ndalohej shkuarja në Shqipëri”⁶⁸, informonte Gruiqi, ministrin e Jashtëm jugosllav.

Pasi qëndrimi i shqiptarëve në Kosovë përkufizohej si interes nacional e shtetëror shqiptar, pa harruar këtu dhe dimensionin njerëzor, shërbimi diplomatik shqiptar bëri përpjekje të vazhdueshme për të gjetur rrugë e metoda në mënyrë që të parandalohesh shpërngulja e tyre.⁶⁹ Në radhë të parë u përkufizuan çështjet e ndjeshme të cilat do të sensibilizonin popullsinë shqiptare-kosovare kundër shpërnguljes, siç ishin: përhapja e idesë se shqiptarët e vendosur në Turqi do të turqizoheshin, pra do ta humbnin karakterin etnik të tyre; jo vetëm kaq, atje të shpërngulurit do të dëmtoheshin edhe në aspektin fetar pasi në

* Atje kishte ngulitje arbëreshësh nga Shqipëria Veriore.

⁶⁵ *AMPJ*, V. 1936, D. 165, fl. 81. Shkresë e R. Ficos drejtuar ministrit të Jashtëm, dr. Fuad Asllani, Beograd, 23 mars 1936.

⁶⁶ *Po aty*, fl. 372. Raport i R. Ficos për Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Beograd, 18 nëntor 1936.

⁶⁷ *DASSIP*, LP, 1935, F. I, Albanija, nr. 825. Raport i ministrit Fuqplotë jugosllav në Londër Grujiq, drejtuar Kryeministrit M. Stojadinoviq, Londër, 24 tetor 1935.

⁶⁸ *Po aty*.

⁶⁹ *AMPJ*, V. 1935, D. 101, fl. 11. Raport i ministrit Fuqplotë në Turqi, R. Fico drejtuar MPJ të Shqipërisë, Angora, 24 prill 1926. Fico mendonte se gjendja shpirtërore e kosovarëve në Turqi të pakënaqur me trajtimin e tyre mund të përdorej si element propagande. Po ashtudhe çështja e fesë. (*Po aty*, V. 1926, D. 101, fl. 22. Shkresë e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, Tiranë, maj 1926).

Turqi po rrezikohej myslimanizmi⁷⁰; të gjithë imamët dhe hoxhallarët e Kosovës⁷¹, duhej të bashkëpunonin dhe mbështesnin “njëri-tjetrin dhe t’i apin djelmënisë mësim shqip, siç asht ba në kohërat e vështira të regjimit turk”; në xhami “t’i apin popullit instruksione që të mos emigrojnë në Turqi ku nuk ka fe as nder, as mikpritje”⁷²; të përkraheshin personalitetet si Ferhat Bej Draga dhe të votoheshin deputetët me “ide kombëtare dhe të ndershëm”; të bëhej propagandë me shkrimet e shtypit të huaj lidhur me devotshmërinë e Shqipërisë ndaj kauzës kombëtare irredentiste; të mbaheshin kontaktet me afaristët patriotë e të tjerë, të cilët udhëtonin në Turqi dhe të cilët ishin të gatshëm për bashkëpunim me përfaqësitë shqiptare në Jugosllavi⁷³; të kooptoheshin informatorë dhe propagandues aktivë për kauzën shqiptare e që ishte kultivimi i patriotizmit dhe shpresës për liri; lutjet e kosovarëve për lehtësimin e shpërnguljes në Shqipëri të refuzoheshin “përveç në rastet e pashpresë”⁷⁴, shto këtu dhe propagandën përmes materialit kulturor (libra, revista, shtypi shqiptar)⁷⁵ të futur ilegalisht në Kosovë etj.

⁷⁰ Propaganda e Tiranës nisi të shfrytëzojë dhe konservatorizmin e shqiptarëve, i cili edhe në të kaluarën pati një rol jo të vogël në ruajtjen e identitetit të tyre etnik e fetar. Shumë shqiptarë, që shkonin në Turqi si turistë për ta përgatitur terrenin për shpërngulje, ktheheshin të dëshpëruar kur shihnin mënyrën e re të jetesës si rrjedhojë e reformave në planin shoqëror dhe hezitonin të shpërnguleshin atje.

⁷¹ Kjo kategori e shoqërisë shqiptare ishte nën tryshninë e madhe nga pushteti jugosllav qoftë duke i përndjekur (si në rastin e shembjes së një xhamie në Prizren ku një shqiptar vrau dy inxhinierët serbë dhe për këtë u dënua rëndë edhe imami i xhamisë si “nxitës” i kësaj vrasjeje (1925), apo dhe duke i shantazhuar dhe korruptuar etj. Një pjesë e tyre me karakter të dobët u ligështua dhe propagandoi shpërnguljen, kurse pjesa tjetër kreu me devotshmëri detyrën kombëtare.

⁷² *AMPJ*, V. 1935, D. 185, fl. 102. Raport i konsullit shqiptar drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme shqiptar Xh. Vila, Stamboll, 26 gusht 1935.

⁷³ *Po aty*, V. 1926, D. 101, fl.11. Ministri Fuqiplotë shqiptar R. Fico drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme, Angora, 24 prill 1926; *po aty*, fl. 22. Shkresë e ministrit të Punëve të Jashtme drejtuar Ministrisë së Brendshme, Tiranë, maj 1926; *po aty*, V. 1935, D. 185/1, fl. 98-103. Analizë e konsullit shqiptar në Stamboll, i cili merrej me çështjen në fjalë, Stamboll, 26 gusht 1935.

⁷⁴ *Po aty*, V. 1935, D. 185, fl. 57-58. Shkresë e Xh. Vilës drejtuar përfaqësive diplomatike shqiptare në Beograd, Shkup, Selanik, Stamboll, Tiranë, 27 prill 1935.

⁷⁵ *Po aty*, V. 1936, D. 165, fl. 56-57. Raport i kryekonsullit shqiptar “Mbi shpërndarjen e librave shqipe në Kosovë” drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme, dr. Fuad Asllani, Shkup, 10 mars 1936.

Qëndrimi britanik ndaj shpërnguljes së shqiptarëve dhe sistemimit të tyre në Shqipëri

Në rrafshin diplomatik, Tirana çështjen e përndjekjes dhe shpërnguljes së shqiptarëve e shtroi dhe me britanikët, si me ministrin Fuqiplotë britanik në Tiranë, atë në Beograd dhe në vetë Ministrinë e Jashtme britanike. Të ndalemi së pari në një takim midis R. Ficos dhe homologut të tij britanik, N. Hendëron (korrik 1935), në Beograd. Pas një ekspozije të tij, lidhur me “gjendjen e katundarëve të mjerë që iu zaptohen tokat”⁷⁶, Hendëron shfaqti bindjen se Jugosllavia ishte i vetmi fqinj i sinqertë i Shqipërisë dhe se ajo ishte kundër synimeve territoriale greke dhe italiane ndaj saj. Hendëron sugjeroi që Shqipëria të vazhdonte përpjekjet për fqinjësi të mirë edhe me qeverinë e re të Stojadinoviçit, dhe njëkohësisht shfaqti mendimin se sikur Mbreti Aleksandër të ishte gjallë “sigurisht edhe çështja e shkollave do të kishte marrë një fund”.⁷⁷ Sipas Hendersonit, vetë Mbreti Aleksandër i kishte treguar për origjinën e tij shqiptare nga Kelmendi, duke dashur ta bindi se afiniteti i nënkuptueshëm ndaj shqiptarëve e përjashtonte mundësinë e një politike përndjekëse ndaj tyre. Britaniku tashmë kishte biseduar për çështjen me Stojadinoviçin, me ç’rast ky kishte premtuar se do të “sillen ma mirë ndaj shqiptarëve”.⁷⁸ Po kështu, ai premtoi se këtë çështje do ta shtronte dhe me regjentin Princ Pavlin.⁷⁹

Ndërkaq, ministri Fuqiplotë shqiptar në Londër F. Asllani, në takimet e zhvilluara me zyrtarë kompetentë të Foreign Office-t (gusht 1935), Sargjent dhe Ker paraqiti një ekspozitë të gjatë për pozitën e “mjerueshme të kosovarëve në Jugosllavi”.⁸⁰ Ai i përshkroi gjithë masat kundër tyre të zbatuara nga pushteti serb për t’i detyruar në emigrim. Pas kësaj, Asllani foli dhe për vështirësitë e shtetit shqiptar për sistemimin e tyre në Shqipëri. Në fund, dorëzoi dhe Memorandumin në të cilin me detaje paraqiteshin masat e qeveritarëve jugosllavë “për shtrëngimin e

⁷⁶ *Po aty*, V. 1935, D. 185, fl. 107-108. Raport i R. Ficos drejtuar ministrit të Jashtëm Xh. Vila, Beograd, 3 korrik 1935.

⁷⁷ *Po aty*.

⁷⁸ *Po aty*.

⁷⁹ *Po aty*.

⁸⁰ *Po aty*, V. 1935, D. 94, fl. 7-9. Raport nga Londra për një bashkëbisedim të ministrit Fuqiplotë shqiptar në Londër me ministrin e Punëve të Jashtme të Britanisë, Londër, 11 maj 1935.

kosovarëve për shpërngulje në Turqi”. Sargjent e dëgjoi me mirëdashje Asllanin dhe shprehu mirëkuptim për “karakterin sentimental” të Tiranës, por ai nuk shihte mënyrë për ta ndihmuar Shqipërinë në këtë çështje. Sargjent premtoi se do ta analizonte Memorandumin por refuzoi që ky t’i dërgohej ministrit Fuqiplotë britanik në Beograd, siç propozoi Asllani.⁸¹ I ballafaquar me këtë pozicionim britanik, Asllani shprehu mendimin se angazhimi nga kjo anë mund të bëhej mbi baza të vullnetit të mirë duke marrë parasysh prestigjin e Britanisë në Ballkan. Më pas me shumë takt diplomatik bashkëbiseduesit të tij britanik i kujtoi interesin e Britanisë së Madhe për marrëdhënie miqësore ndërmjet shteteve ballkanike dhe për eliminimin e shkaqeve që mund të çonin drejt ndonjë konflikti ndërmjet tyre.⁸² Në raportin vjetor të legatës britanike në Beograd evidencohet se lidhur me ankesën e palës shqiptare në Londër, ka qenë e pamundur që në Beograd “të sigurohet çfarëdo dëshmie të cilat do të mbështesnin pohimet në ankesën (shqiptare) për raste të përndjekjes së pa drejtë...kurse interesimi pran Ministrisë së Punëve të Jashtme (jugosllave) ka hasur në mohimin kategorik se është praktikuar një politikë e tillë”.⁸³

Ky qëndrim i ftohtë e pa takt diplomatik i britanikëve ishte indikacion i pozicionimit mospërfillës të tyre ndaj çështjes së pozitës, përndjekjes e dëbimit të shqiptarëve nga ana e regjimit jugosllav.⁸⁴ Prandaj, Asllani propozonte që diplomacia dhe institucionet e tjera shqiptare të vepronin në drejtim të nxitjes së miqve shqiptarë në Londër, siç ishte E. Bojll, i cili mund ta shtynte çështjen e shpërnguljes së shqiptarëve në Parlamentin Britanik. Për t’i dhënë forcë kësaj iniciative do të duhej të animoheshin dhe gazetarë britanikë të ndonjë gazete me ndikim të cilët të financuar nga Tirana do të vizitonin Kosovën dhe atje ta shihnin situatën për së afërmi.⁸⁵

⁸¹ *Po aty.*

⁸² *Po aty.*

⁸³ *The National Archives*, London (më tej: *TNA*), FO 371/19576, R 6197/219/92. Raport vjetor i legatës britanike në Beograd për FO.

⁸⁴ Kur në vitin 1925, mbas propozimit të Mit’hat Frashërit, atëherë ministër Fuqiplotë në Greqi, Shqipëria kërkoi nga Lidhja e Kombeve 3 milion fr. ari për sistemimin e emigrantëve shqiptarë nga Greqia, etj., gazeta gjysmë zyrtare e Beogradit *Politika* (28 dhjetor 1925), kishte siguruar informacionin sipas të cilit Kryeministri britanik Çembërln nuk kishte prirje që kjo ndihmë t’i jepej Shqipërisë dhe vërtetë nuk iu dha.

⁸⁵ *AMPJ*, V. 1935, D. 94, fl. 7-9. Raport për një bashkëbisedim të ministrit Fuqiplotë shqiptar në Londër me ministrin e Punëve të Jashtme të Britanisë, Londër, 11 maj 1935.

Por në anën tjetër, Londra u tregua shumë e interesuar lidhur me informacionet që kishin rrjedhur nga sekretari i Sali Vuçiternës⁸⁶, sipas të cilit Tirana, më konkretisht, Mbreti Zog, kishte në plan që në zonën ku shtriheshin grekofonët të instalonte 1500 familje kosovare. Vetë ministri i Jashtëm britanik⁸⁷ u angazhua që Tiranës t’ia bënte me dije se “një projekt i tillë” do të ishte shkatërrimtar dhe se nëse ky “projekt” ekzistonte dhe realizohej, atëherë Shqipëria, përfundimisht do ta humbte simpatinë dhe qëndrimin miqësor britanik.⁸⁸ Madje, Londra paralajmëronte se ajo “nuk mund të qëndronte indiferente”, në rast se do të ndodhnin konflikte midis muhamedanëve kosovarë dhe grekofonëve, e që mund të pritej nëse “projekti” në fjalë jetësohej. Ajo kërkoi nga Tirana përgjigje lidhur me këtë çështje, duke ia bërë me dije se nga kjo varej sjellja e Britanisë ndaj Shqipërisë.⁸⁹ Një kërcënim i hapur e pa ekuivok i Britanisë së Madhe ndaj shtetit shqiptar për mundësinë që të cenohej rehatia e “grekofonëve” apo struktura nacionale në atë region.

Aq më tepër, Londra ishte e prirë që ankesat e Tiranës për çështjen e shqiptarëve të përndjekur t’i interpretonte si qëllim të saj për zhvendosjen e vëmendjes nga emigrimi i grekëve nga Jugu dhe mundësinë e trazirave atje.⁹⁰ Kësaj duhet t’i shtohet dhe prirja britanike që t’i besohej mohimeve të Beogradit ndaj ankesave shqiptare lidhur me efektet e zbatimit të Reformës Agrare⁹¹, sepse sipas tyre “Do të ishte e palogjikshme që muhamedanët konservatorë kosovarë të emigronin në Turqi, ku do t’i nënshtroheshin një trajtimi në kundërshtim me vlerat e tyre fetare e tradicionale”.⁹² Por megjithatë, ministri Fuqiplotë britanik në

⁸⁶ *Po aty*.

⁸⁷ *Po aty*, V. 1935, D. 135, fl. 25. Raport i ministrit Fuqiplotë shqiptar në Londër drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Londër, 24 korrik 1935. Ministri i ri i Jashtëm S. Hoare e njihte mirë Shqipërinë që nga Lufta e Parë Botërore kur kishte pasur angazhime lidhur me të, po dhe nga miku i tij Obri Herbert, prandaj siç ishte shprehur ai “situata dhe mirëqenia e Shqipërisë e kanë interesuar përherë”.

⁸⁸ *Po aty*, V. 1935, D. 94, fl. 7-9. Raport për një bashkëbisedim të ministrit Fuqiplotë shqiptar në Londër me ministrin e Punëve të Jashtme të Britanisë, Londër, 11 maj 1935.

⁸⁹ *Po aty*.

⁹⁰ *Po aty*. Sa i përket ankesës së Tiranës për pamundësitë materiale e financiare për sistemimin e shqiptarëve të përndjekur, Londra fajësonte korrupsionin në mesin e të autorizuarve për këtë çështje, siç ishte Sali Vuçiterni me bashkëpunëtorët e tij.

⁹¹ *TNA*, FO 371/1957, R 6197/2119/92. Raport vjetor (1935) për gjendjen në Jugosllavi, punuar nga ministri fuqiplotë britanik në Jugosllavi për FO.

⁹² *Po aty*.

Shqipëri, Hoxhson u shpreh i rezervuar ndaj pohimeve jugosllave për qëndrim të kujdesshëm dhe korrekt ndaj kësaj popullsie. Në kthim e sipër për në Shqipëri nga pushimet verore në Beograd, ai pati një takim me Stojadinoviçin, me ç'rast, siç edhe i kishte premtuar Tiranës, e shtroi çështjen e pozitës së minoritetit shqiptar. Kryeministri jugosllav e kishte mohuar ushtrimin e ndonjë përndjekjeje ndaj shqiptarëve, por njëkohësisht kishte pranuar se në fakt do ta dëshironte shpërnguljen e tyre, madje do ta ndihmonte Shqipërinë financiarisht për këtë qëllim* dhe në vend të tyre të sillte kushërinj nga gjaku (malazias).⁹³

Duhet evidencuar se nga dokumentacioni britanik⁹⁴ del se midis dy Luftërave Botërore, në Londër ka pasur një prirje që ndaj pozitës së popullsisë shqiptare në Jugosllavi të mbyllej një sy dhe çështja t'i lihej kohës. Thënë ndryshe, Jugosllavisë t'i lihej dorë e lirë në trajtimin e kësaj çështjeje duke e konsideruar si një çështje të brendshme të saj.

Tirana ndërmjet “synimeve irredentiste” dhe të një “kolonizimi racional”

Nga autorë të huaj e shqiptarë po dhe nga bashkëkohës diplomatë e politikanë, është pohuar se kreatori kryesor i politikave shqiptare, Ahmet Zogu dhe bashkëpunëtorët e tij, kishin hequr dorë nga synimet “irredentiste”. Por në ç’përmasë qëndron ky konstatim përkundër deklaratave të rastit⁹⁵ të tyre? Zogu si politikan realist e kishte të qartë se një politikë aktive irredentiste nga shteti shqiptar përjashtohet nga konteksti i dhënë ndërkombehtar, nga marrëdhëniet specifike të Shqipërisë

* Kemi të bëjmë me idenë e shpërnguljes së shqiptarëve në Shqipëri.

⁹³ TNA, FO 371/ 19477, R 6724/889/90. Raport i ministrit Fuqiplotë britanik në Shqipëri drejtuar ministrit të Jashtëm britanik S. Hoare, Durrës, 12 nëntor 1935.

⁹⁴ Për këtë shih në përmbledhjen e dokumenteve britanike - raportet vjetore të legatës së Britanisë së Madhe në Beograd të përgatitura për botim nga historiani jugosllav Živko Avramovski, *Britanci o Kraljevini Jugoslaviji 1922-1938*, knjiga I-II, Arhiv Jugoslavije-Globus, Zagreb: 1986.

⁹⁵ DASSIP, Zbirka V. J. M, F-19, 1929, “Albanija”. Referat i M. Jeliq përgatitur për Mbretin Aleksandër të Jugosllavisë, më 13 shkurt 1929. Në fillim të vitit 1929, Mbreti Zog i kishte deklaruar M. Jeliqit, gazetar e shkrimtar në fakt i besueshmi i Mbretit Aleksandër sa vijon: “Thonë se unë dëshiroj të shkëpus Kosovën nga ju. Kjo është e pamundshme, sikur edhe çdo gjë të shkonte në të mirë të këtij qëllimi. Ne nuk kemi nëpunës as për këtë territor, e lëre më për një territor të zmadhuar”. Për këtë shih tek Emine Arifi-Bakalli, *Çështje nga historia moderne dhe bashkëkohore shqiptare*, Instituti Albanologjik, Prishtinë: 2011, f. 43.

me Jugosllavinë dhe në fund të fundit nga raporti i forcave në relacion me këtë shtet. Deklaratat publike dhe ato jopublike të Zogut se ndër prioritetet e tij ishte shkatërrimi i Komitetit të Kosovës⁹⁶, i cili nga të gjithë perceptohej si strumbullar i irredentizmit shqiptar, në esencë nuk kishin të bënin me thelbin e programit të këtij Komiteti. Para së gjithash, ky synim kishte të bënte me funksionimin e këtij Komiteti si “shtet brenda shtetit” dhe rrezikun që vinte nga ky për trazira eventuale të natyrës politike në Shqipëri të ngjashme me ato të viteve 1921-1922, po dhe 1924.

Në të vërtetë, Zogu dhe rrethi i tij, Kosovën dhe kosovarët i konsideronin me interes kombëtar. Kjo pasqyrohet përmes dokumentacionit arkivor shqiptar, atij jugosllav⁹⁷ dhe burimeve të tjera e sidomos përmes atyre që kanë të bëjnë me relacionet shqiptaro-italiane.⁹⁸ Për të mbështetur konkretisht dimensionin “irredentist” të Tiranës zyrtare, po ndalemi në disa shembuj. Së pari, çdo herë dhe kudo në rastet solemne që kishin të bënin me të kaluarën kombëtare apo me ndonjë ngjarje të rëndësishme shtetërore, sintagma “ideali kombëtar shqiptar”⁹⁹ ishte e paevitueshme dhe konstante. Edhe këmbëngulja e Tiranës që titulli mbretëror i Zogut të përkufizohej si “mbret i shqiptarëve”, i cili u kundërshtua jo pak nga Jugosllavia¹⁰⁰, është tregues domethënës për çështjen në fjalë dhe është perceptuar si argument “irredentist” në mesin

⁹⁶ “Komiteti Kosovar”, *Politika*, Beograd, 3 janar 1925, f. 3.

⁹⁷ Në raportet sidomos të atasheve ushtarakë jugosllavë në Shqipëri të shumtën e rasteve zinte vend dhe rubrika “Komiteti i Kosovës”, brenda së cilës evidencohet çdo aktivitet dhe çdo manifestim, qoftë një deklaratë gojore lidhur me shqiptarët në Jugosllavi dhe lidhur me Kosovën. Shih raportet në fjalë në fondin e pasur arkivor për ish Ushtrinë Jugosllave (Popisnik 17) 1925-1939 i ruajtur në Arkivin e Institutit Ushtarak-Beograd.

⁹⁸ Për këtë shih H. Bello, *Marrëdhëniet shqiptaro-turke*; Ilir Ushtelenca, *Diplomacia e Mbretit Zogu I-rë (1912-1939)*, Tiranë: 1995 (ribotuar Tiranë: Ermir, 1997); *I Documenti Diplomatici Italiani (DDI)*, Settima serie (1922-1935), vol. IV, Roma: La libreria dello Stato, 1962; Arkivi i fshehtë i kontit Çiano, ditari i tij, kujtimet e diplomatëve italianë me shërbim në Shqipëri etj.

⁹⁹ *AJ, CPB* (38-20-61), 1929, Albanija. Raport i atasheut jugosllavpër shtypin, Tiranë, 18 tetor 1929. Në hapjen e Sesionit të dytë të Parlamentit Shqiptar Zogu kishte deklaruar: “Zhvillimi i rinisë shqiptare dëshmon dhe premtan se do ta realizojmë idealin kombëtar”. “Ideali kombëtar shqiptar” ka nënkuptuar bashkimin e tokave shqiptare me theks të veçantë bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Jugosllavët këtë sintagmë e interpretonin si shprehje synimi irredentist të Tiranës.

¹⁰⁰ *DASSIP*, PP, 1928, f. 1-1, nr. 500. “Raport nga Tirana”. Shkresë informative e MPJ të Jugosllavisë për legatën jugosllave në Paris, Beograd, 18 gusht 1928.

e shqiptarëve brenda e jashtë Shqipërisë. Nga ajo që u tha më parë dhe shembujt në vijim (1925, 1926, 1935) del se Kosova dhe parandalimi i emigrimit të kosovarëve, nga establishmenti shqiptar konsiderohej si çështje e një rëndësie të jashtëzakonshme për vetë qëndrueshmërinë dhe ardhmërinë e shtetit shqiptar.¹⁰¹ Kështu, pas deklaratës së ministrit të Jashtëm turk, Tefik Ruzhdi për mundësinë që nga Serbia të pranoheshin 3-400.000 myslimanë, R. Fico konstatonte se "...kjo ka me qenë vdekja e idealit t'onë kombëtar, dhe Tyrqia po na banë varrin e ardhurisë t'onë".¹⁰² Në të njëjtën kohë edhe përfaqësuesi shqiptar në Beograd Gj. Pekmezi, kur po raportonte për angazhimin "metodik e sistematik" të Beogradit për "serbizimin e Kosovës" dhe lehtësimin e largimit të banorëve të saj duke i pajisur me pasaporta "edhe kaçakët që janë në mal ... për me shkue në Turqi"¹⁰³, dhe po propozonte një ankesë nga ana e shtetit shqiptar drejtuar Lidhjes së Kombeve për masat kundër shqiptarëve, konstatonte sa vijon: "frika asht se mbrenda pak vjetvet si prej çfarosjes e serbizimit ashtu dhe prej emigracionit, rasa jonë do të zhduket krejt prej Kosovës e kjo do t' ishte një dam tepër i madh për kombin t' onë i cili do të humbiste afro një milion të birëve të vet".¹⁰⁴ Ndërkaq, në shkresën e kryetarit të shtetit A. Zogu, drejtuar ministrit të Jashtëm I. Vrioni nga i

¹⁰¹ AMPJ, V. 1925, D. 113, fl. 32. Shkresë e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë drejtuar ministrit Fuqiplotë në Athinë, M. Frashëri, Tiranë, 12 tetor 1925. Ky kishte shprehur mendimin se shqiptarët e shpërngulur duhej të sistemoheshin në Shqipëri, ndërsa ministri i Jashtëm, nga ky kombinim përjashtonte kosovarët, shpërngulja e të cilëve do të dëmtonte "kombin". (*Po aty*, V. 1925, D. 111, fl. 35, Tiranë, shtator 1925).

¹⁰² *Po aty*, V. 1926, D. 101, fl. 9. Shkresë e ministrit Fuqiplotë R. Fico drejtuar ministrit të Jashtëm I. Vrioni, Ankara, 24 prill 1926; *po aty*, V. 1926, D. 101, fl. 6-7. Raport i ministrit Fuqiplotë në Turqi Fico drejtuar ministrit të Jashtëm I. Vrioni. Sipas ministrit Fuqiplotë austriak në Turqi A. Kral, këtë gjë e kishte pohuar ministri Tefik Ruzhdi në bisedë, Ankara, 30 mars 1926, me ministrin Fuqiplotë sovjetik po dhe me ambasadorin e Persisë në Ankara.

¹⁰³ *Po aty*, V. 1925, D. 112, fl. 140-143. Shkresë e gjatë e kryesit të punës Gj. Pekmezi drejtuar presidentit A. Zogu, Beograd, 22 qershor 1925. "Serbizimi i Kosovës".

¹⁰⁴ *Po aty*, V. 1925, D. 134, fl. 7-10. Shkresë-analizë e Gj. Pekmezit për gjendjen e kosovarëve drejtuar ministrit të Jashtëm shqiptar; Ky kishte zgjedhur dhe një artikull të gazetës *Obzor*, 31 gusht 1925 (Zagreb), në të cilën evidencoheshin masat e Beogradit kundër shqiptarëve si: serbizimi përmes shkollave; ndalesë për përdorimin e gjuhës shqipe dhe e çfarëdo libri që mund të edukonte në frymën kombëtare shqiptarët; grabitja e pasurisë së shtresës së pasur dhe konfiskimi i pronave tjera në të cilat vendoseshin malaziasit e rusët. "Të gjithë ata që mbajnë kapelë të bardhë vriten si lepuj", evidencohet ndër të tjera në këtë gazetë.

cili kërkohet angazhim imediat pranë qeverisë turke në mënyrë që ajo mos të pranonte shqiptarë nga Kosova, konstatohej se shpërngulja e “aq vllazënevet tanë” shkaktonte “dam kombëtar”.¹⁰⁵ Edhe ministri i Jashtëm I. Vrioni, Kosovën e cilësonte “bastion më i rëndësishmi kombëtar verior”, prandaj banorët e saj duhej të qëndronin në pronat e tyre, sepse, kjo sipas tij, kishte rëndësi kapitale për “kombin dhe shtetin t’onë”.¹⁰⁶

Konstruksione për rëndësinë jetike që kishte Kosova, banorët e saj për Shqipërinë, po përsëriteshin dhe në vitin 1935, kohë kjo kur presioni për shpërngulje mori përmasa të mëdha. Ministri i Jashtëm shqiptar i kohës, Xh. Vila konstatoi se parandalimi i shpërnguljes së kosovarëve paraqiste “rëndësi jetike për Shqipërinë”.¹⁰⁷

Nisur nga këto të dhëna mund të konstatohet se angazhimi i shtetit shqiptar për përmirësimin e pozitës së shqiptarëve në Jugosllavi si parakusht për parandalimin e shpërnguljes së tyre, përveç dimensionit njerëzor dhe obligimit që dilte nga normat ndërkombëtare, kishte në vete dhe dimensionin irredentist. Por, gjithsesi ky i fundit, më shumë mbetej në suaza të një perspektive jo aq të qëndrueshme, e cila eklipsohej nga mundësia e një spastrimi etnik të Kosovës e më gjerë. Aq më keq duke u nisur nga kjo mundësi, pra në rast se shpërngulja masive e “kosovarëve” në Turqi nuk mund të parandalohej, Tirana nisi të reflektojë për një mundësi tjetër sipas së cilës duhej bërë çmos që ata të vendoseshin në Shqipëri.¹⁰⁸ Vendosja e tyre aty, apo siç nisi të përdorej në zhargonin politik e diplomatik shqiptar “kolonizimi racional” me emigrantët “kosovarë”, perceptohej si një infuzion regjenerues, fuqizim demografik, ekonomik dhe politik, sepse tashmë po vërehej shpopullimi i saj.*

Madje, ky option në fillim të vitit 1936, pati zhvillime konkrete. Në takimin që Mbreti Zog pati me ministrin Fuqiplotë jugosllav Gjonoviq, në vargun e çështjeve që do të duhej të trajtoheshin midis dy vendeve

¹⁰⁵ AMPJ, V. 1925, D. 111, fl. 62. Shkresë e Kryetarit të Republikës drejtuar ministrit të Jashtëm I. Vrioni, Tiranë, 9 prill 1929.

¹⁰⁶ *Po aty*, V. 1926. D. 101, fl. 14. Shkresë e ministrit të Punëve të Jashtme të Shqipërisë, I. Vrioni, Tiranë, 24 maj 1926.

¹⁰⁷ *Po aty*, V. 1935, D. 185, fl. 57-58. Shkresë e Xh. Vilës drejtuar legatës në Beograd, konsullatave në Shkup dhe Stamboll, Tiranë, 27 prill 1935.

¹⁰⁸ *Po aty*, V. 1936, D. 129, fl. 75. Shkresë drejtuar Mbretit Zog nga ministri i Punëve të Jashtme shqiptar ku evidencohet urdhri i Mbretit Zog “për riatdhesimin e Kosovarvet ...”, Tiranë, 2 nëntor 1936.

* Për të parandaluar rrjedhjen e popullsisë nga Shqipëria, Parlamenti Shqiptar aprovoi ligjin sipas së cilit ndalohej që familja t’i bashkohej një emigranti jashtë shtetit.

ishte dhe çështja e ndihmës financiare e ndërlidhur me “çështjen e kolonizimit të shqiptarëve” që nënkuptonte gatishmërinë e Shqipërisë për pranimin e një numri të madh të shqiptarëve nga Jugosllavia.¹⁰⁹ Gjonoviq i entuziazmuar për një mundësi të tillë, bëri dhe një analizë për format e ndihmës dhe mënyrën e zbatimit të tyre në këtë rast. Ai mendonte se ndihma financiare për rimëkëmbjen ekonomike të Shqipërisë gjatë fazës pesëvjeçare të “kolonizimit” të saj me shqiptarët e Kosovës, duhej siguruar dhe me pjesëmarrjen e anëtarëve të Paktit Ballkanik dhe Lidhjes së Kombeve.¹¹⁰ Çështjen e kishte shtruar dhe me ministrin Fuqiplotë britanik në Shqipëri Hoxhson, të cilit kjo ide i kishte pëlqyer dhe prandaj pritej përkrahje edhe nga kjo anë.¹¹¹ Sipas legatës britanike në Beograd nga sondazhi pranë qeverisë jugosllave doli se iniciativa në fjalë kishte rrjedhur nga pala shqiptare në kohën kur kjo kishte “kuptuar” se midis qeverisë jugosllave dhe asaj turke po zhvilloheshin bisedime për shpërnguljen e 200 000 mijë shqiptarëve në Anadoll.¹¹² Ndërsa, sipas ministrit Fuqiplotë britanik në Shqipëri, ky ishte informuar se “qeveria jugosllave kishte kërkuar nga ajo shqiptare që zyrtarisht ta trajtojnë mundësinë e pranimit të rreth 40-50 mijë fshatarëve shqiptarë nga Kosova”.¹¹³

Përkundër dyshimeve dhe përpjekjeve të të dy palëve që këtë iniciativë t’ia atribuonin tjetrës, më 23 korrik 1936, legata jugosllave në Tiranë, i dorëzoi Ministrisë së Punëve të Jashtme shqiptare një Aide-Memoire lidhur me një marrëveshje jugosllavo-shqiptare për “emigrimin e myslimanëve shqiptarë të Jugosllavisë në Shqipëri ...”.¹¹⁴ Në hyrje të këtij dokumenti shprehimisht evidencohej predispozita e palës shqiptare për një marrëveshje të tillë me Jugosllavinë. Sipas kësaj projekt-marrëveshjeje, qeveria shqiptare duhej të shprehte gatishmëri për pranimin e 10.000 familjeve të shqiptarëve myslimanë brenda pesë vitesh nga 2000 sosh për vit (neni 1). Në Nenin 2 të kësaj projekt-marrëveshjeje parashihej

¹⁰⁹ AJ, F. i Milan Stojadinoviqit, F-37. Raport i ministrit Fuqiplotë Gjonoviq drejtuar Kryeministrit M. Stojadinoviq, Tiranë, 8 shkurt 1936.

¹¹⁰ *Po aty.*

¹¹¹ *Po aty.*

¹¹² TNA, FO 371/21194, R 3281/8/92. Raport vjetor për vitin 1936 i legatës britanike në Beograd drejtuar FO.

¹¹³ *Po aty.*

¹¹⁴ AMPJ, V. 1936, D. 165, fl. 146-147. Dokumenti për projekt-marrëveshjen në fjalë, i cili sipas pranuesit duhej dorëzuar Kryeministrit M. Frashëri, ministrit Dh. Berati dhe ministrit të Jashtëm Xh. Vila, Tiranë, 17 korrik 1936.

që emigrantët shqiptarë, tokat dhe shtëpitë do t'ia linin shtetit jugosllav, kurse ishin të lirë që të merrnin mobiljet dhe kafshët shtëpiake. Si kompensim për shtëpitë dhe tokat e emigrantëve qeveria jugosllave do të vente në dispozicion të qeverisë shqiptare një shumë globale prej 10.000 dinarë për çdo familje pesë anëtarësh (Neni 3). Pjesa tjetër e këtij projekti (Neni 4, 5, 6, 7) kishte të bënte me anën praktike dhe financiare të çështjes. Bie në sy, se nga shuma e paraparë për familje vetëm 20% e saj do t'i jepej qeverisë shqiptare. Thithja e pjesës tjetër të kësaj pagese duhej aranzhuar përmes allishverisheve tregtare e financiare me Jugosllavinë.¹¹⁵

Por, siç dihet, ideja për shpërnguljen në masë të “kosovarëve” në Shqipëri mbeti në embrion, sepse asnjëra nga palët nuk ishin të dedikuara ndaj këtij zhvillimi. Përkundër ballafaqimit me një mundësi të tillë, angazhimi i përhershëm dhe parësor i Tiranës për shqiptarët në Jugosllavi mbeti përpjekja që ata të gëzonin të drejtat elementare minoritare në frymën e normave ndërkombëtare. Madje, Tirana mund të “kënaqej” edhe vetëm me heqjen dorë nga përndjekja aktive e permanente e shqiptarëve nga pushteti jugosllav, gjë që për rrethanat do të përjashtohej shpërngulja e tyre. Por, përkundër maturisë zyrtare të demonstruar nga Tirana dhe mohimit të “synimeve irredentiste” nga ana e saj¹¹⁶, Beogradi përcillte me shumë kujdes¹¹⁷ dhe reagonte ndaj çdo aktiviteti a manifestimi, i cili nga ai konsiderohej si irredentizëm shqiptar.

Ndërkaq, hezitimi i Jugosllavisë ekspansioniste ndaj mundësisë së dëbimit të “kosovarëve” në Shqipëri, kishte të bënte me frikën nga

¹¹⁵ *Po aty*. 80% të pagesës jugosllave “sera mis a sa disposition pour des achats ou autres paiements a effectuer en Yougoslavie”.

¹¹⁶ Në komunikimin diplomatik Tiranë-Beograd mesazhet e këtij lloji kanë qenë të shpeshta. Këtë e deklaroi dhe Mbreti i saposhpallur Zogu i Parë, pas akuzave nga Beogradi për titullin e tij me konotacion irredentist “Mbret i shqiptarëve”. Në porosinë për Mbretin Aleksandër të Jugosllavisë në vitin 1928, Mbreti Zog pohon: “...Thonë se unë dëshiroj të shkëpus Kosovën nga ju, kjo është e pamundshme, sikur edhe çdo gjë të shkojë në favor të këtij qëllimi. Ne nuk kemi nëpunës as për këtë territor, e lëre më për një territor të zmadhuar” (*DASSIP*, Zbirka V. J. Maramboa, F. 19, 1929, Albanija. Referat i përgatitur për Mbretin Aleksandër nga M. Jeliq.

¹¹⁷ Me rastin e hapjes të sesionit të dytë të Parlamentit Shqiptar (tetor 1929), atasheu për shtyp jugosllav në fjalimin e rastit të Mbretit Zog, evidencoi dhe raportoi fjalinë sipas tij irredentiste. “Zhvillimi i rinisë shqiptare na jep shpresë se do të realizojmë idealin kombëtar...”, - kishte deklaruar Mbreti Zog (*AJ*, CPB (Centralni Pres Biro) (38-20-61), 1929. Raport i atasheut për shtyp jugosllav për CPB jugosllave, Tiranë, 18 tetor 1929.

përqendrimi i shqiptarëve “irredentistë” me predispozitë antiserbe në këtë shtet. Kjo ngase këta do të bëheshin strumbullar i rezistencës me rastin e depërtimit të trupave ushtarake jugosllave në këtë vend në kohën kur në rend dite do të shtrohej zgjidhja definitive e çështjes shqiptare.* Në anën tjetër, zhvillimet politike në nivel rajonal e më gjerë, dhe sidomos kapacitetet reale të Turqisë, më shumë favorizonin një marrëveshje jugosllavo-turke, e cila do të mundësonte dëbimin masiv të shqiptarëve si prelude të eliminimit të faktorit shqiptar në Ballkan.

S u m m a r y

ALBANIA'S CONFRONTATION WITH THE POSITION OF ALBANIANS IN YUGOSLAVIA (1935)

One of the issues that affected the Albanian-Yugoslav relations in the period between the two world wars was the position of the Albanians in Yugoslavia. Serbian diplomatic discourse presented Albanians as rebels, problematic and anti-state elements, while Serbian domestic political discourse defined them as arnauts or Ottoman remains, who had their place in Turkey. As a result, Serbian political thought focused on finding ways to achieve ethnic cleansing of Albanian areas. According to Serbian calculations, this goal could be achieved through the signing of an agreement with Turkey on the mass and systematic displacement of Albanians.

According to the information of the Albanian diplomatic missions, at the beginning of 1935, the emigration of “Kosovars to Turkey was getting bigger day by day”. In the face of this situation, the Albanian government instructed the Albanian consulates in Skopje, Thessaloniki and Istanbul to take the following measures: *First*, to conduct an intensive propaganda among the Albanians, so that they would not be displaced from their settlements; *Second*, to work with the Albanian refugees who were left for Turkey, so that they could return to Albania; *Third*, to keep in touch with the Albanians who had arrived in Turkey so that they would not take up residence there, but to move in the direction of Albania.

Throughout Tirana, Tirana's primary commitment to the Albanians in Yugoslavia remained the effort to preserve their national identity and enjoy basic minority rights like all other minorities in Europe. In the face of the

* Kjo zgjidhje nënkuptonte eliminimin e shtetit shqiptar, ndarjen e tij me Greqinë.

phenomenon of Kosovo Albanians leaving for Turkey, the coming of them in Albania was perceived as a regenerative infusion, demographic, economic and political empowerment for the Albanian state. King Zog envisioned the installation of 1,500 Kosovar families in the area inhabited by the Greek-speaking population. However, this project met with strong opposition from the British government. The British Foreign Secretary demanded that official Tirana to be informed that if this "project" was implemented, Albania would eventually lose the sympathy and friendly attitude of Great Britain.

